

NJOFTIM PARAPRAK

për shpallje të Thirrjes publike 01/2017 për dorëzimin e kërkesave për shfrytëzimin e mjeteve nga Instrumenti për ndihmë parahyrëse për zhvillim rural të Unionit Evropian (2007-2013 IPARD II)

Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural i lajmëron të gjithë personat e interesuar juridik dhe fizik se në muajin janar 2017 do të shpallet Thirrja publike për dorëzimin e kërkesave për shfrytëzimin e mjeteve financiare nga komponenti i pestë e Instrumentit për ndihmë parahyrëse për zhvillim rural të Unionit Evropian (IPARD Programi për periudhën 2014-2020)

Qëllimi i IPARD Programit 2014-2020 është përmes zhvillimit të kapitalit njerëzor dhe fizik të përmirësohet siguria e ushqimit dhe aftësia e sektorit bujqësor – ushqimor për ballafaqim me konkurrencën e tregut, si dhe harmonizim të shkallëzuar të sektorit me standardet e Bashkimit Evropian, posaçërisht ato që kanë të bëjnë me higjienën dhe mjedisin jetësor, ndërsa në drejtim të arritjes së zhvillimit të barabartë territorial të mjediseve rurale.

Mjetet financiare nga IPARD Programi 2014-2020 (Gazeta Zyrtare e RM nr. 177/16) në lidhje me realizimin e kësaj Thirrje publike nga janari i vitit 2017 dedikohen për masat në vijim:

- Investime në mjetet materiale të ekonomive bujqësore,
- Investime në mjetet materiale për përpunim dhe marketing të prodhimeve bujqësore dhe të peshqve,
- Diverzifikim të fermave dhe zhvillim të bizneseve.

Rregullat për shfrytëzimin e mjeteve financiare nga IPARD Programi 2014-2020 udhëzojnë arritjen e kontratës paraprake të shfrytëzuesve potencial me Agjencinë për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural dhe realizimin e investimit të lejuar në pajtim me kushtet e kontraktuara paraprakisht. Kontrollim në vend të ngjarjes dhe zbatimin e mbikëqyrjes së kontratës e kryejnë personat e autorizuar nga Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural dhe institucionet relevante të Republikës së Maqedonisë për udhëheqje, zbatim dhe kontroll të IPARD dhe Unioni Evropian.

Mënyra dhe procedura për shfrytëzimin e përkrahjes financiare nga IPARD Programi 2014-2020 janë të shënuara në Rregulloren për mënyrën dhe procedurën për shfrytëzimin e përkrahjes financiare për masat për zhvillim rural të financuara nga Programi IPARD 2014-2020 (Gazeta Zyrtare e RM nr. 64/16)

Shpallja do të zgjasë **45 ditë** nga dita e shpalljes së Thirrjes publike në shtypin ditor.

VËREJTJE: Dokumentacioni i duhur për përgatitje dhe dorëzim të kërkesave, duke përfshirë dhe Udhëzimet për shfrytëzuesit e mjeteve nga IPARD Programi 2014-2020 do të azhurnohen dhe publikohen në ueb faqen e Agjencisë në periudhën deri në shpalljen e Thirrjes publike.

Informata më detale në lidhje llojet e investimeve, kriteret për fitimin e përkrahjes financiare, lartësia e përkrahjes sipas masave të interesuarit mund t'i marrin në

Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural

Telefoni : 02 3097-460

Faks: 02 3097-454

e-mail adresa: ipardpa.info@ipardpa.gov.mk

www.pa.gov.mk

Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomizimit të ujërave

Spektori për udhëheqje me IPARD

Telefoni : 02 3134-477

Lok : 113, 114 dhe 115

e-mail adresa: info@ipard.gov.mk

www.ipard.gov.mk

Agjencia për nxitje të zhvillimit në bujqësi

Telefoni: 047 228-330

Faksi: 047 228-370

www.agencija.gov.mk çdo ditë pune prej ora 8:30 deri në ora 16:30.

Informata për përgatitjen dhe dorëzim të kërkesave, si dhe këshillat praktike për aplikim, prodhues të interesuarit bujqësorë falas mund t'i marrin në qendrat regionale të Agjencisë për nxitje të zhvillimit në bujqësi. (Lista e kontakteve të qendrave regionale dhe personave kompetentë është e shpallur në ueb faqen e institucioneve kompetente).



**Instrumenti për ndihmë paraqasëse e Bashkimit Evropian
për zhvillim rural
(IPARD) 2007-2013**

